



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 56

Prishtinë, më 12.3.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri.

Munguan : Daut Haradinaj, Etem Arifi dhe Liburn Aliu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MMPH, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 29.2.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbeturina,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime. U miratua edhe shqyrtimi për sot i njoftimit nga Komisioni për Komunitete rreth fshatit Hoça e Madhe.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.2.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 29.2.2012.

3. Shqyrtimi i informatës nga Komisioni për Komunitete

Nait Hasani njoftoi komisionin për kërkesën e komisionit për komunitete pas takimit të datës 21.2.2012 kur janë takuar dy kryetarët me nënkryetar të komisionit funksional dhe komisionit për komunitete rreth amendamenteve që i ka miratuar ky komision për Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe. Ai sqaroi se ky komision pas takimit të cekur tani pajtohet me të gjitha amendamentet e komisionit funksional përveç me Amendamentin 1 ku kërkohet të shtohet fjala “fetare” pas fjalës “kulturore”, si dhe të Amendamenti 4 ku kërkohet të mbetet varianti i propozuar nga Qeveria me një anëtarë nga kisha ortodokse. Komisioni për komunitete përmes informatës me shkrim nga dt. 28.2.2012 kërkon që komisioni funksional prapë të prononcohet për këto ndryshime.

Komisioni pas shqyrtimit të sërishëm të amendamenteve të këtij komisioni rreth Projektligjit për fshatin Hoça e Madhe konstatoi se fjala “fetare” nuk ka nevojë të shtohet ngase fjala “kulturore” përfshinë edhe atë, ndërkaq me amendamentin 4 ky komision ka reaguar për shkak të mbrojtjes së kushtetutës ngase përfaqësimi laik është e ndaluar, ndaj nxjerr këtë :

P Ë R F U N D I M

Mbeten në fuqi amendamentet e Komisionit Funksional dt. 13.1.2012 rreth Projektligjit për fshatin Hoça e Madhe.

Përfundimi i dërgohet komisionit përkatës me arsyetimin nga kjo mbledhje .

4. Projektligji për Mbeturina

Rreth shqyrtimit të projektligjit në fjalë u konstatua se nuk prezanton eksperti Behxhet Shala, ndaj pasi që kryetari kërkoj falje për këtë mungesë sugjeroi të mbahet mbledhja nesër në orën 10,00.

5. Të ndryshme

Nait Hasani në këtë pikë konstatoi si vijon :

- **OJQ Syri Vision** fton komisionin për një takim rreth monitorimit të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, por pasi që nuk dihet saktë agjenda e punës së Kuvendit, Kryetari premtoi zyrtarit të OJQ se komisioni të enjten do të njoftoi më saktë kur mund të mbahet takimi në javën tjetër.
- Sekretari i MMPH ka njoftuar për dërgimin e Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje në Kuvend dhe ka kërkuar një procedurë urgjente nga Komisioni pasi që kemi të bëjmë me çështje fundamentale dhe të rëndësishme, njëherit ka sugjeruar një vizitë të Komisionit në vendin ku janë krijuar përvoja me këto ndërtime.
- Pasi që do të mbahet organizimi rajonal në Komunën Plavë-Mali i Zi, për zonën e Bjeshkëve të Nemuna me mbështetjen financiare të OJQ “Triton”, më 15 dhe 16 mars 2012 në këto takime udhëton zyrtari i komisionit **Ylber Sherifi**.
- Komisioni do të vizitoi KEK ditën e premte më 16 mars 2012 prej orës 10,00. Të njoftohen zyrtarët e KEK dhe të Komunës Obiliq.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 11,40.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani

